



Centre for Political Courage

CPC Paper Series

Paper #1

**EFEKTET POLITIKE TË SISTEMEVE
ZGJEDHORE: SIMULIM ME RASTIN E
KOSOVËS**

Centre for Political Courage (CPC)

Prishtinë, Prill 2014

© Copyright CPC, të gjitha të drejtat e rezervuara.

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet dhe opinionet e CPC-së.

Autor:

Arben Qirezi: Efektet politike të sistemeve zgjedhore: Simulim me rastin e Kosovës, CPC Paper Series, Paper #1, Prishtinë 2014.

Editor:

Arben Hajrullahu

CPC falenderon Fondacionin Friedrich Ebert, Zyra në Prishtinë, për mbështetjen e ofruar në realizimin e këtij studimi.



Përmbajtja

Hyrje	5
Përkufizimi.....	5
Qëllimi i studimit	6
Sistemi i shumicës relative në zonë njëmandatëshe (SMP)	6
Simulimi i SMP-së në rastin e Kosovës sipas rezultateve zgjedhore të vitit 2010	8
Rezultatet e simulimit të SMP në rastin e Kosovës	12
Vota alternative	19
Variacionet e sistemeve proporcionale	20
Vota e vetme e transferueshme (VVT)	21
Konkluzion	24
Shtojcë	26

Tabelat

Tabela 1: Krahasim i përqindjes së votave dhe mandateve parlamentare në Britaninë e Madhe në zgjedhjet e viteve 1983-1997	7
Tabela 2: Përparësitë dhe mangësitë e sistemit të shumicës relative me zonë njëmandatëshe (SMP).8	
Tabela 3: Ndarja e zonave zgjedhore sipas numrit të votuesve pas krijimit të 10 zonave zgjedhore në komunat e vogla	11
Tabela 4: Rezultatet e simulimit të sistemit SMP në Prizren në bazë të rezultateve zgjedhore të vitit 2010	13
Tabela 5: Rezultatet e simulimit të sistemit SMP në Pejë në bazë të rezultateve zgjedhore të vitit 2010	14
Tabela 6: Rezultatet e simulimit të sistemit SMP në Gjakovë në bazë të rezultateve zgjedhore të vitit 2010	15
Tabela 7: Rezultatet e simulimit të sistemit SMP në Gjilan në bazë të rezultateve zgjedhore të vitit 2010	16
Tabela 8: Krahasim i rezultatit të përgjithshëm të simulimit të SMP-së sipas rezultateve të zgjedhjeve të vitit 2010	17
Tabela 9: Përparësitë dhe mangësitë e Votës alternative (VA)	19
Tabela 10: Rezultati i zgjedhjeve me votë Alternative (Preferenciale) për Parlamentin e Australisë në Divizionin Hinkler në Queensland në vitin 1998	20
Tabela 11: Paraqitja e kalkulimit të votave nga modifikimi i tabelës nga zgjedhjet e vitit 1987 në zonën zgjedhore të Korkut në Irlandë	22
Tabela 12: Përparësitë dhe mangësitë e sistemit proporcional VVT	23

Figurat

Figura 1: Vota proporcionale sipas rezultateve zgjedhore të vitit 2010 pa mandate të rezervuara	26
Figura 2: Mandatet parlamentare aktuale me mandate të rezervuara	26
Figura 3: Ndarja e mandateve parlamentare në mënyrë proporcionale pa vende të rezervuara	27
Figura 4: Simulimi i ndarjes së mandateve parlamentare sipas sistemit SMP në bazë të votave për parti (jo për kandidatë) në vitin 2010	27

Shkurtesat dhe akronimet

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKR	Aleanca Kosova e Re
FER	Partia „Fryma e Re”
KDTP	Kosova Turk Demokratik Partisi
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LDD	Lidhja Demokratike e Dardanisë
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
SMP	Zone njëmandatëshe me shumicë relative (Single member district)
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Kosovës
VA	Vota alternative
VV	Lëvizja Vetëvendosje
VVT	Vota e vetme e transferueshme

Hyrje

Që nga viti 2001 kur kishte filluar hartimi i Kornizës Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse debatohet kur më shumë e kur më pak lidhur me sistemin zgjedhor në Kosovë. Megjithatë, aktorët vendorë kanë pasur pak ndikim në këtë debat. Mund të thuhet, madje, se ky debat në mesin e elitave politike dhe shoqërisë civile të Kosovës ka qenë i kufizuar brenda kornizave të përcaktuara nga aktorët ndërkombëtarë, të cilët qysh herët janë përcaktuar për sistemin proporcional (PR) me mbi-përfaqësim të komuniteteve pakicë përmes mandateve të rezervuara. Në anën tjetër, debati në mesin e ndërkombëtarëve për llojin e sistemit zgjedhor të Kosovës gjatë viteve 2000-2001 ka qenë përmbajtjesor dhe ka përfshirë shqyrtimin e përshtatshmërisë së sistemeve të tjera zgjedhore, sidomos të sistemit të shumicës relative me zonë zgjedhore njëmandatëshe (SMP). Megjithatë, në këtë debat nuk kanë qenë të përfshirë aktorët politikë vendorë, meqenëse ai është zhvilluar ekskluzivisht në mesin e ndërkombëtarëve.¹

Përkufizimi

Për të racionalizuar debatin lidhur me sistemin zgjedhor në Kosovë, së pari duhet të sqarojmë dallimin në mes të sistemit zgjedhor dhe rregullave zgjedhore. Sipas Gallagher dhe Mitchell, sistemi zgjedhor përcakton se si votohet në zgjedhje dhe se si këto vota shndërrohen në mandate (ulëse) parlamentare.² Sipas këtij përkufizimi, sistemi zgjedhor përcakton përbërjen e parlamentit apo të një organi përfaqësues të zgjedhur me votë popullore. Rrjedhimisht, në njërën anë, kjo përbërje përcakton në mënyrë indirekte edhe përbërjen e ekzekutivit, si dhe i bën më të parashikueshme vendimet dhe proceset politike të një vendi. Në anën tjetër, rregullat zgjedhore përcaktojnë detajet e procesit zgjedhor, duke përfshirë administrimin e zgjedhjeve, të drejtën e votës, mënyrën e kandidimit (vota për një apo më shumë kandidatë, lista e hapur apo e mbyllur etj.), transparencën e numërimit të votave, vëzhgimin etj.³

Tema e legjislacionit zgjedhor po e dominon debatin mbi reformën zgjedhore, që në fakt nuk është reformë, por modifikim i sistemit zgjedhor, ose ndryshim i ligjit zgjedhor. Rrjedhimisht, në Kosovë, nuk është mbajtur asnjëherë një debat i mirëfilltë dhe gjithëpërfshirës publik mbi reformën e sistemit zgjedhor.

¹ Arben Qirezi: Intervention and Consociationalism: The Role of External Dimension in Shaping Post-war Kosovo 1999-2012, unpublished Ph.D. Thesis, National University of Ireland, Galway 2014.

² Michael Gallagher, Paul Mitchell: Introduction to Electoral Systems, in: Michael Gallagher and Paul Mitchell (eds.): The Politics of Electoral Systems, New York 2008, f. 3.

³ Po aty.

Qëllimi i studimit

Tash e tre vjet në Kosovë është iniciuar një debat mbi reformën e sistemit zgjedhor. Për shkak të parregullsive të përsëritura të procesit zgjedhor, debati në Kosovë është përqendruar shumë edhe në çështjet që i përkasin ligjit zgjedhor, por shumë pak, ose fare nuk është diskutuar në mënyrë të informuar mbi atë se cili sistem zgjedhor do t'i përshtatej më shumë Kosovës në rrugën e saj të tranzicionit drejt një shoqërie të qëndrueshme demokratike. Në fakt, ky debat është i kufizuar në atë se çfarë lloj sistemi proporcional (PR) duhet të ketë Kosova: me lista të hapura apo të mbyllura, një zonë apo më shumë zona zgjedhore, pragu zgjedhor, dhe reprezentimi për komunitetet pakicë. Të gjitha këto çështje kanë ndikim politik, por opinioni publik, shoqëria civile dhe në shumicën e rasteve edhe ata që janë të përfshirë në vendimmarrje nuk e kanë të qartë se cilat janë këto ndikime dhe çfarë pasojash sjellin modifikimet e përfolura në sistemin zgjedhor të Kosovës. Prandaj, ky debat nuk është i vënë në kontekstin e asaj se cili është qëllimi i reformës së sistemit zgjedhor.

Propozimi është që të bëjmë një shqyrtim të një numri të sistemeve zgjedhore duke simuluar, aty ku është e mundur, skenarët e sistemeve zgjedhore në Kosovë duke marrë për bazë aktorët aktual politikë. Në këtë mënyrë debati do të vendosej në kontekst të efekteve të dëshiruara apo të padëshiruara të reformës së sistemit zgjedhor në procesin politik të Kosovës. Qëllimi i këtij studimi është informimi i palëve të interesit lidhur me efektet politike të ndryshme zgjedhore në mënyrë që të ngjallet një debat përmbajtësor rreth sistemit zgjedhor, si dhe të ndikohet në informimin e vendimmarrësve politikë për të formuluar preferencat e tyre mbi sistemin zgjedhor. Njëkohësisht, është me rëndësi që opinioni publik i Kosovës të identifikojë motivet e partive politike për preferencat e tyre për sistemin përkatës zgjedhor të Kosovës.

Duke qenë se dallimet më të mëdha dhe të pa-eksploruara deri më tani janë ndërmjet sistemeve SMP dhe PR, ky studim do të përqendrohet në efektet politike të këtyre dallimeve dhe pastaj do të përshkruajë në përgjithësi pasojat politike të SMP, të sistemit të Votës Alternative (VA), si dhe të Votës së Vetme të Transferueshme (VVT) si lloj i sistemit proporcional.

Sistemi i shumicës relative në zonë njëmandatëshe (SMP)⁴

Arsyeja përse është zgjedhur diskutimi i pasojave politike të këtij sistemi është sepse për këtë lloj sistemi angazhoheshin dy partitë më të mëdha politike të Kosovës, LDK dhe PDK, gjatë bisedimeve për Kornizën Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse.⁵ SMP përdoret nga rreth 45 shtete të botës. Përndryshe, SMP përdoret nga shumica e votuesve në botë, por kjo vetëm duke iu falënderuar popullsisë së madhe që e ka India. Sistemet proporcionale, në anën tjetër, përbëjnë trendin mbizotërues në aplikimin e sistemeve zgjedhore në botë.⁶

Karakteristikë e SMP është thjeshtësia e tij. Votuesit duhet të shënojnë një kandidat në listën e kandidatëve për parlament. Mandatet janë të ndara sipas zonave zgjedhore dhe mandatin e fiton kandidati që ka më së shumti vota në raport me kandidatët e tjerë, jo domosdo shumicën absolute të

⁴ Më tutje do të përdoret shkurtesa në gjuhën angleze SMP.

⁵ Andrew J. Taylor: Electoral Systems and the Promotion of „Consociationalism” in a Multiethnic Society. The Kosovo Assembly Elections of 2001, in: Electoral Studies, 24 (2005), f. 443.

⁶ David M. Farrell: Electoral Systems: A Comparative Introduction, New York 2001.

votave. Këtu është edhe kritika më e madhe ndaj këtij sistemi sepse deputetët nuk zgjidhen me shumicën absolute të votave, kurse një numër i madh e votave të elektoratit humbasin. Karakteristikë tjetër është se SMP prodhon qeveri stabile dhe se politikat e qeverisë janë të parashikueshme. Po ashtu, SMP zakonisht sjell mbipërfaqësimin e partisë më të madhe dhe lehtëson krijimin e shumicës parlamentare. Si pasojë e kësaj, koalicionet janë të rralla, për dallim nga sistemet proporcionale në të cilat qeveria formohet pas zgjedhjeve në bazë të negociatave ndërmjet partive politike. Për më shumë, karakteristikë tjetër, dhe mbase më e rëndësishmja, është se në SMP votuesit nëpër zona zgjedhore përfaqësohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kandidatët fitues, gjë që bën që përfaqësimi i qytetarëve të jetë më i qartë dhe ata e dinë se kujt mund t'i drejtohen me kërkesat e tyre.

Sa për ilustrim, në vijim paraqiten rezultatet e zgjedhjeve në Britaninë e Madhe sipas sistemit SMP, duke i krahasuar rezultatet e SMP në bazë të përqindjes së votave të fituara dhe përqindjes së vendeve të fituara për tri parti më të mëdha në katër palë zgjedhjet parlamentare që janë mbajtur në periudhën 1983-1997. Kjo tabelë tregon atë që do të mund të shihej edhe nga një simulim i shndërrimit të proporcionalit në SMP në rastin e Kosovës. Kjo është se SMP-ja favorizon partitë e mëdha dhe ato që kanë bazë zgjedhore në rajone të caktuara gjeografike, dhe disfavorizon partitë më të vogla dhe ato që e kanë votën e shtrirë në mbarë territorin e Kosovës, por të cilat nuk kanë ndonjë bazë regjionale.

Tabela 1: Krahasim i përqindjes së votave dhe mandateve parlamentare në Britaninë e Madhe në zgjedhjet e viteve 1983-1997⁷

<i>Vitet zgjedhore</i>	Partia Konservatore			Partia Laburiste			Partia Liberal-Demokratike		
	<i>Votat %</i>	<i>Mandatet %</i>	<i>Dallimi %</i>	<i>Votat %</i>	<i>Mandatet %</i>	<i>Dallimi %</i>	<i>Votat %</i>	<i>Mandatet %</i>	<i>Dallimi %</i>
1983	42.4	61.1	+18.7	27.6	32.2	+4.6	25.4	3.5	-21.9
1987	42.3	57.8	+15.5	30.8	35.2	+4.4	22.6	3.4	-19.2
1992	41.9	51.6	+9.7	34.4	41.6	+7.2	17.8	3.1	-14.7
1997	30.7	25	-5.7	43.2	63.4	+20.2	16.8	7	-9.8

Në tabelën vijuese paraqiten disa nga përparësitë dhe mangësitë e SMP-së në rrafshin teorik. Disa nga fenomenet tipike që i shkakton ky sistem duken edhe tek tabela paraprake. Kështu, për shembull, në 7 nga 8 rastet, dy partitë më të mëdha, ajo Konservatore dhe ajo Laburiste, patën një mbipërfaqësim në mandate në krahasim me përqindjen e votave të fituara. Ky mbipërfaqësim sillej prej 4.4% deri 20.2%. Në të gjitha rastet, mbipërfaqësimi, që sillej ndërmjet 9.7% deri 20.2%, ka qenë më i madh për partinë që ishte fituese e zgjedhjeve, duke i sjellë asaj shumicën absolute të

⁷ Po aty, f. 27.

mandateve vetëm në bazë të shumicës relative të votave. Nga ana tjetër, Partia Liberal-Demokratike në të katër rastet ka qenë e nënpërfaqësuar në mandate në krahasim me përqindjen e votave të fituara. Ky nënpërfaqësim sillet prej 9.8% në zgjedhjet 1997 deri në 21.9% në zgjedhjet 1983.

Tabela 2: Përparësitë dhe mangësitë e sistemit të shumicës relative me zonë njëmandatëshe (SMP)

Sistemi SMP	
PËRPARËSITË	MANGËSITË
Thjeshtësia	Shpërpjesëtimi në përfaqësim
Përfaqësimi i votuesve në mënyrë të drejtpërdrejtë	Shumica e votave humbasin
Qeveria stabile	Mundësitë për dialog politik janë më të vogla
Parashikueshmëria e politikave	Politikat mund të jenë më ideologjike dhe tensionet më të larta
Kufizon skenën politike në parti të mëdha dhe në ato me koncentrim gjeografik	Dëmton partitë më të vogla me shtrirje të gjerë dhe zvogëlon opsionet politike

Që të dy tabelat e sipërme do të krahasohen me simulimin e SMP-së në rastin e Kosovës sipas rezultateve të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010, në mënyrë që të hipotetizohet se sa do të na kishin ardhur në shprehje fenomenet e vërejtura në tabelën nr. 1 dhe ato që ceken në tabelën nr. 2.

Simulimi i SMP-së në rastin e Kosovës sipas rezultateve zgjedhore të vitit 2010

Të dhënat nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), të cilat janë të ndërtuara për sistemin aktual proporcional me një zonë zgjedhore, e bëjnë të pamundur një simulim me rezultate reale për mbarë territorin e Kosovës për tri arsye: 1) Krijimi i zonave zgjedhore nëpër komuna në bazë të ndarjes së tyre sipas qendrave aktuale të votimit nuk jep numër të njëjtë të votuesve për zonë zgjedhore; 2) Transferimi i rezultateve të zgjedhjeve proporcionale në rezultate sipas sistemit SMP nuk mund të tregojë rezultate reale për shkak se në sistem proporcional votohet për parti (në rastin e Kosovës jepen edhe votat preferenciale brenda listës partiake); 3) Simulimi i sistemit SMP në situatën kur ekzistojnë mandatet e garantuara dhe kur numri i partive politike është i madh e bën një kalkulim të tillë edhe më problematik.⁸

⁸ Për të ndërtuar zonat zgjedhore, është përdorur dokumenti i KQZ „Rezultatet e subjekteve sipas vendvotimeve”. Shih: http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/rezultatet_e_subjekteve_sipas_vendvotimeve_bbxnbzawtq.pdf

Prandaj, në këtë rast, do të bëhet një simulim i pjesshëm i rezultatit zgjedhor në disa komuna për të konkluduar se cilat do të mund të ishin efektet politike të aplikimit të sistemit SMP në Kosovë duke ndarë zonat zgjedhore të cilat reflektojnë 120 mandate parlamentare në Kuvendin e Kosovës. Në fakt, qëllimi i këtij simulimi është të paraqesë një pasqyrë të rrjedhave politike që do të mund krijoheshin, pa paragjykuar partitë të cilat merren në shqyrtim. Janë disa kufizime të këtij simulimi të SMP-së në Kosovë, të cilat ndikojnë që kjo pasqyrë të mos jetë më shumë sesa një aplikim hipotetik. Arsyet kryesore për këtë janë:

- Zgjedhjet e vitit 2010 janë mbajtur sipas sistemit proporcional dhe votat u janë dhënë së pari partisë e pastaj votuesi ka pasur mundësinë të shpreh preferencat për kandidatët në lista partiake;
- Mund të ketë dallime ndërmjet votës për parti në proporcional dhe votës për kandidatë në SMP;
- Sjellja e partive/kandidatëve dhe e votuesve mund të ndryshojë varësisht prej sistemit zgjedhor;
- Krijimi i zonave zgjedhore është bërë duke bashkuar qendrat aktuale të votimit gjë që nuk garanton përpjesëtim të drejtë të numrit të votuesve për zonë zgjedhore.

Në rastin kur është bërë simulimi i rezultateve zgjedhore, sa për të simuluar aplikimin e SMP, janë zbatuar këto parime:

- Për të ndarë numrin e zonave zgjedhore sipas parimit bazë se çdo komunë ka së paku një zonë zgjedhore, së pari janë krijuar 10 zona zgjedhore në komunat me më pak se 1% të votuesve. Pas kësaj, numri i mbetur prej 110 zonave zgjedhore është ndarë ndërmjet komunave të tjera sipas përqindjes së votuesve për komunë në raport me numrin e përgjithshëm të votuesve në Kosovë dhe 110 mandateve parlamentare, duke përdorur për këtë listat e votuesve për zgjedhjet komunale të vitit 2013, gjë e cila ka rezultuar me numër jo të barabartë të votuesve për zonë zgjedhore;
- Komunat me numër më të vogël të votuesve, ose komunat me shumicë të votuesve nga komunitetet pakicë që kanë komunat e tyre, krijojnë përparësi në zgjedhje. E metë e kësaj metode është se komunitetet e shpërndara gjeografikisht siç janë komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian do të gjendeshin në pozitë të pafavorshme, njëlloj sikurse edhe boshnjakët dhe goranët, të cilët, ndonëse jetojnë më të përqendruar në disa vendbanime, po ashtu nuk kanë komuna të krijuara sipas parimit etnik. Me këtë edhe do të favorizoheshin shqiptarët dhe serbët e Kosovës, dhe jo pakicat tjera. Tek pakicat e tjera kjo do të paraqiste thyerje të besimit se sistemi zgjedhor në Kosovë shfrytëzohet si instrument i paqes dhe jo i demokratizimit, ku e para shihet si parakusht për te dytën; dhe

Të dhënat në këtë dokument kanë mospërrputhshmëri në numër të votave të subjekteve politike me dokumentin tjetër të KQZ, „Rezultatet e subjekteve sipas komunave”. Shih: http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/rezultatet_e_subjekteve_sipas_komunave_stadbxhmx.pdf Lëshimet eventuale në këtë studim janë pasojë e këtyre mospërrputhshmërive në dokumentet e publikuara të KQZ.

- Kufijtë komunalë janë përdorur si kriter bazë për krijimin e zonave zgjedhore, gjë e cila favorizon votuesit e komunave më të vogla, sepse në të gjitha zonat zgjedhore në komunat me më shumë se një zonë zgjedhore numri i votuesve është më i madh sesa numri i votuesve në zonat zgjedhore në komunat që janë një zonë e vetme zgjedhore. Megjithatë, kjo ndikon që të krijohet një disbalancë në mes të komunave sa i përket numrit të votuesve për deputetë.

Duke patur parasysh mangësitë që krijojnë këto parime, komunave të tjera i është ndarë numri i zonave zgjedhore sipas përqindjes së votuesve. Kur e kemi parasysh se çdo zonë zgjedhore e zgjedh një deputet, atëherë numri i deputetëve për komunë është proporcional me numrin e votuesve, por pak i modifikuar, duke marrë parasysh inxhinieringun (Gerrymandering afirmativ) i cili ka pasur për qëllim që secila komunë të përfaqësohet dhe që sa më shumë komunitete etnike të përfaqësohen po ashtu. Në këtë aspekt, SMP do të mund të aplikonte krijimin e zonave zgjedhore në atë mënyrë që numri i votuesve për zonë të jetë i barabartë në mbarë territorin e Kosovës, duke përfshirë vendbanime jashtë kufijve administrativë të komunave me numër më të vogël të votuesve, por kjo do të ndikonte negativisht në përfaqësimin e komuniteteve më të vogla etnike.

Sipas kësaj, numri i votuesve nëpër komunat ku është aplikuar simulimi është ndarë duke u bazuar në numrin e votuesve të regjistruar për zgjedhjet lokale të vitit 2013, duke qenë se kjo është lista më e fundit dhe më e përditësuar e votuesve në mbarë territorin e Kosovës, përfshirë edhe votuesit në komunat me shumicë nga komuniteti serb. Komunat të cilat janë në gjysmën e presjes dhjetore ose e tejkalojnë atë, e kanë një zonë zgjedhore më shumë.⁹ Kjo është arsyeja e mungesës së përpjesëtimit të drejtë të numrit të votuesve dhe zonave zgjedhore në të gjitha komunat. Duke qenë se ky propozim mbështetet në inxhiniering elektoral për t'u mundësuar komunave të vogla të jenë të përfaqësuara, një shpërpjesëtim i tillë është i pashmangshëm, siç paraqitet edhe në tabelën vijuese.¹⁰

⁹ P.sh. nëse një komunë i ka 2.49% të votuesve, i takojnë 3 zona zgjedhore. Nëse një komunë ka 3.1% të votuesve, por numri i përgjithshëm i votuesve të saj tejkalon numrin e votuesve të komunës paraprake për 8,000 votues, asaj përsëri i takojnë 3 zona zgjedhore.

¹⁰ Në këtë tabelë janë marrë të dhënat e KQZ mbi votuesit e regjistruar për zgjedhjet e vitit 2013. Përditësimi i mëtuqjeshëm i listave të votuesve nuk është marrë parasysh për shkaqe praktike.

Tabela 3: Ndarja e zonave zgjedhore sipas numrit të votuesve pas krijimit të 10 zonave zgjedhore në komunitat e vogla¹¹

Komuna	Numri i votuesve sipas listave zgjedhore të zgjedhjeve lokale të 2013	Përqindja e përgjithshme e votuesve	Përqindja e votuesve për 110 mandate parlamentare	Numri i zonave zgjedhore
Decan	40173	2.27%	2.49	3
Dragash	39466	2.23%	2.45	2
F. Kosovë	32136	1.82%	2	2
Ferizaj	101164	5.73%	6	6
Gjakovë	107890	6.11%	6.7	7
Gjilan	95530	5.41%	5.9	6
Gllgovc	50079	2.83%	3.1	4
Gracanice	19216	1.08%	1.18	1
H. Elezit	8501	0.48%	/	1
Istog	46277	2.62%	2.8	3
Junik	5542	0.31%	/	1
Kacanik	32338	1.83%	2	2
Kamenicë	37307	2.11%	2	2
Klinë	44503	2.52%	2.7	3
Kllkot	3414	0.19%	/	1
Leposaviq	19567	1.10%	1	1
Lipjan	55505	3.14%	3.45	4
Malishevë	48094	2.72%	2.9	3
Mamushë	3587	0.20%	/	1
Mitrovicë J.	72800	4.12%	4.5	5
N. Berdë	9269	0.52%	/	1
Obiliq	23456	1.30%	1.4	1
Partesh	4342	0.24%	/	1
Pejë	104477	5.92%	6.5	7
Podujevë	80987	4.58%	5	5
Prishtinë	174048	9.80%	10.78	11
Prizren	157764	8.90%	9.8	10
Rahovec	54214	3.00%	3.3	4
Ranillug	5532	0.31%	/	1
Shterpcë	13866	0.78%	/	1
Shtime	24507	1.32%	1.45	2
Skenderaj	52587	2.90%	3.2	4
Suharekë	62291	3.50%	3.8	4
Viti	46726	2.60%	2.9	3
Vushtrri	68331	3.80%	4.2	5
Z. Potok	8979	0.50%	/	1
Zvecan	10012	0.56%	/	1

¹¹ Numri i votuesve sipas komunave në kolonën e parë është marrë nga Statistikat e KQZ për zgjedhjet komunale të vitit 2013. Qasur më 25 Dhjetor 2013, në: http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/3%20-%20MAsembly%20-%20Statistics%20by%20Municipality%20-%20excluded%20Zvecan_cjtlgjqng.pdf

Votat e humbura të paraqitura në tabelat e mëposhtme (4, 5, 6, 7) nuk paraqesin të gjitha votat e humbura, por vetëm votat e partive parlamentare që në simulim kanë fituar së paku një mandat parlamentar. Pra, numri i përgjithshëm i votave të humbura të vitit 2010 do të ishte më i madh, por edhe nëse do të aplikohesh SMP-ja në realitet, edhe numri i partive politike që do të garonin do të ishte kushtimisht më i vogël. Një paraqitje e tillë në sistemin SMP nuk do të ishte reale në bazë të zgjedhjeve proporcionale, sepse numri i partive politike që garojnë në sistemin proporcional është në parim më i madh. Duhet pasur parasysh se për shkak të mungesës së përditësimit konsekuent të listave zgjedhore dhe për shkak të zhvendosjes së popullsisë brenda Kosovës dhe jashtë saj, në disa komuna, numri i votuesve paraqitet më i madh sesa numri i banorëve të regjistruar prandaj në përgjithësi numri i saktë i votuesve është i diskutueshëm. Megjithatë, simulimi në këtë studim ka mundur të mbështetet vetëm në të dhënat zyrtare të ofruara nga KQZ për zgjedhjet lokale të vitit 2013, në të cilat mungon Mitrovica e veriut.

Rezultatet e simulimit të SMP në rastin e Kosovës

Analiza e të dhënave nga komunat tregon disa gjetje të cilat do t'i paraqesim në bazë të rezultateve të gjeneruara nga zgjedhjet e vitit 2010. Si komunë shumë-etnike, Prizreni tregon trende interesante në raportin e votuesit dhe partive politike.

Tabela 4: Rezultatet e simulimit të sistemit SMP në Prizren në bazë të rezultateve zgjedhore të vitit 2010¹²

	KDTP	AKR	VAKAT	LDK	VV	AAK	PDK	Fituesi	Votat e humbura të partive parlamentare për zonë zgjedhore dhe në total
Zona zgjedhore 1	765	236	81	1218	770	262	1155	LDK	3269
Zona zgjedhore 2	1645	575	254	2170	1158	660	1877	LDK	6169
Zona zgjedhore 3	1151	356	216	1473	955	530	1492	PDK	4681
Zona zgjedhore 4	224	303	300	1105	644	465	2197	PDK	3041
Zona zgjedhore 5	2	61	0	2488	460	892	3209	PDK	3903
Zona zgjedhore 6	0	47	25	794	244	570	2206	PDK	1680
Zona zgjedhore 7	0	79	1988	833	194	276	1147	VAKAT	2529
Zona zgjedhore 8	381	173	648	1028	380	752	1191	PDK	3362
Zona zgjedhore 9	118	74	692	1042	324	497	1401	PDK	2747
Votat e humbura për parti	4286	1904	2216	8763	5129	4904	4179	17072 vota fituese	31381

Nëse do t'i merrnim për bazë rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2010 duke simuluar sistemin SMP, del se partitë minoritare mund të fitojnë nëse ato janë të përqendruara si shumicë në një zonë zgjedhore, ashtu sikurse ndodh me partinë VAKAT në zonën zgjedhore 7 të Prizrenit. Në anën tjetër, edhe pse me numër mjaft të madh, të gjitha votat e KDTP-së do të humbasnin sepse ato nuk arrijnë të kenë një shumicë relative në asnjërën prej zonave zgjedhore. Kjo do të sugjeronte se në rastin e aplikimit të SMP-së, votuesit e VAKAT dhe të KDTP do të duhej të mbështesnin një parti që mund të

¹² Tabelat nr. 3, 4, 5, 6 janë bazuar në të dhënat e KQZ për zgjedhjet e përgjithshme 2010: KQZ, 2010. Zgjedhjet e përgjithshme 2010, Rezultatet e subjekteve sipas vendvotimeve. Qasur më 25 Dhjetor 2013, në: http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/rezultatet_e_subjekteve_sipas_vendvotimeve_bbxnbzawtq.pdf

sigurojë shumicën në vendet ku partitë e tyre etnike nuk do të kishin gjasa për të fituar shumicë relative. Nga kjo del se parimi etnik, i cili është motivuesi kryesor për votuesit në sistemin proporcional, do të dobësohej në dobi të një qasjeje më integruese politike, sepse edhe partitë e shumicës do të duhej t'u kushtonin vëmendje më të madhe qytetarëve të komuniteteve pakicë në mënyrë që të përfitojnë votat e tyre. Rezultatet e gjeneruara po ashtu tregojnë se votimi në zgjedhje sipas sistemit proporcional është etnik dhe se partitë e shumicës nuk përpiqen t'u apelojnë votuesve nga komunitetet e tjera. Përndryshe, Prizreni tregon një trend të ndarjes së votës ndërmjet dy partive më të mëdha, PDK-së dhe LDK-së.

Në anën tjetër, Peja dhe Gjakova janë dy shembuj që tregojnë përparësinë e partive të vogla që kanë bazë të fortë regionale në sistemin SMP. Kështu, AAK, e cila i ka 11.04% të votave në tërë territorin e Kosovës, do të arrinte të fitonte 7 mandate në Pejë dhe 3 mandate në Gjakovë. Këtu nuk janë të llogaritura edhe mandatet e tjera në qytetet ku AAK ka arritur të mbizotërojë në zgjedhjet e vitit 2010. Pra, sipas një përlllogaritjeje të përafërt, marrë për bazë koncentrimin rajonal në përfundim të Kosovës, në sistemin SMP AAK do të arrinte të rrisë numrin e mandateve parlamentare në krahasim me rezultatet e arritura sipas sistemit proporcional të vitit 2010.

Tabela 5: Rezultatet e simulimit të sistemit SMP në Pejë në bazë të rezultateve zgjedhore të vitit 2010

	AKR	LDK	VV	AAK	PDK	Fituesi	Votat e humbura për zone zgjedhore dhe në total
Zona zgjedhore 1	540	1067	876	1339	327	AAK	2810
Zona zgjedhore 2	483	905	771	1184	517	AAK	2676
Zona zgjedhore 3	588	1350	1090	1511	517	AAK	3545
Zona zgjedhore 4	248	1045	550	1386	976	AAK	2719
Zona zgjedhore 5	110	1543	481	3436	1600	AAK	3734
Zona zgjedhore 6	78	968	406	1477	489	AAK	2829
Zona zgjedhore 7	216	1558	704	1965	863	AAK	3341
Votat e humbura për parti (përveç votave të AAK)	2263	8436	4878		5289	12298	21654

Trend të njëjtë paraqet edhe simulimi i rezultateve të AKR-së, e cila, edhe pse me numër të përgjithshëm të votave prej 7.29%, do të mund të arrinte 4 mandate parlamentare, duke iu falënderuar rezultatit zgjedhor në 4 prej 7 zonave zgjedhore të Gjakovës ku ajo ka arritur rezultat të konsiderueshëm në zgjedhjet e vitit 2010.

Tabela 6: Rezultatet e simulimit të sistemit SMP në Gjakovë në bazë të rezultateve zgjedhore të vitit 2010

	<i>AKR</i>	<i>LDK</i>	<i>VV</i>	<i>AAK</i>	<i>PDK</i>	<i>Fituesi</i>	<i>Votat e humbura për zone zgjedhore dhe në total</i>
<i>Zona zgjedhore 1</i>	2264	594	930	991	443	AKR	2958
<i>Zona zgjedhore 2</i>	1980	492	818	723	467	AKR	2500
<i>Zona zgjedhore 3</i>	2772	699	920	1048	528	AKR	3195
<i>Zona zgjedhore 4</i>	1330	632	722	1215	467	AKR	3036
<i>Zona zgjedhore 5</i>	99	1234	421	1235	839	AAK	2593
<i>Zona zgjedhore 6</i>	145	857	297	2617	640	AAK	1939
<i>Zona zgjedhore 7</i>	109	716	283	2053	643	AAK	1751
<i>Votat e humbura për parti</i>	353	5224	4391	3977	4027	14251	17972

Në anën tjetër, simulimi po ashtu tregon se partitë me shtrirje të gjerë të votës, por pa ndonjë bazë të rëndësishme zgjedhore, do të pësonin humbje të mandateve parlamentare sipas sistemit SMP. Kështu p.sh. siç paraqitet në Tabelën 5, në bazë të simulimit të paraqitur në këtë studim që bazohet në rezultatet e vitit 2010, VV-ja do të arrinte t'i fitonte vetëm dy mandate parlamentare në Gjilan, kurse do t'i humbiste 86.7% të votave në pjesën tjetër të territorit të Kosovës, ose 12 mandate parlamentare të cilat i ka fituar me sistemin proporcional.

Tabela 7: Rezultatet e simulimit të sistemit SMP në Gjilan në bazë të rezultateve zgjedhore të vitit 2010

	<i>AKR</i>	<i>LDK</i>	<i>VV</i>	<i>AAK</i>	<i>PDK</i>	<i>Fituesi</i>	<i>Votat e humbura për zone zgjedhore dhe në total</i>
<i>Zona zgjedhore 1</i>	595	1377	1546	396	1575	PDK	3914
<i>Zona zgjedhore 2</i>	635	1305	1711	362	1372	VV	3674
<i>Zona zgjedhore 3</i>	739	1496	1850	519	1638	VV	4392
<i>Zona zgjedhore 4</i>	808	1444	1759	494	1909	PDK	4505
<i>Zona zgjedhore 5</i>	435	1881	1322	480	2402	PDK	4118
<i>Zona zgjedhore 6</i>	399	1175	1101	316	1958	PDK	2991
<i>Votat e humbura për parti</i>	3611	8678	5782	2567	3010	11405	23594

Në total, sipas rezultateve të përafërta të paraqitura në Tabelën 6, simulimi aktual në njëfarë mënyre pasqyron atë që ndodhë në Britaninë e Madhe. Pra, SMP-ja siguron dominim të partisë më të madhe, por edhe krijon një opozitë më të fuqishme sepse agregon votën në një numër më të vogël të partive politike. Kjo madje ndodh edhe në situatën kur është aplikuar inxhinieringu elektoral për të siguruar përfaqësimin e komunave më të vogla si dhe përfaqësimin e komunitetit serb.

Më poshtë paraqitet një simulim i rezultateve të përgjithshme të dala nga simulimi i SMP-së në bazë të metodës së shpjeguar në fillim të këtij seksioni. Në kolonën e parë janë dhënë mandatet aktuale në Kuvendin e Kosovës që përfshin mandatet e rezervuara për komunitetet pakicë dhe pragun zgjedhor prej 5%. Në kolonën e dytë janë dhënë rezultatet e ndarjes proporcionale të mandateve parlamentare pa vende të rezervuara, por duke mos i përfshirë partitë që për shkak të pragut zgjedhor nuk kanë arritur të hyjnë në parlament në vitin 2010 (FER dhe LDD). Në kolonën e katërt janë llogaritur rezultatet e simulimit të SMP-së në bazë të rezultateve zgjedhore sipas qendrave të votimit nga të cilat janë krijuar zonat zgjedhore. Në kolonën e pestë është paraqitur dallimi ndërmjet votës proporcionale dhe mandateve parlamentare po qese do të aplikohet SMP-ja, kurse në kolonën e fundit është paraqitur mesatarja e votave të nevojshme për një kandidat të zgjedhur për secilën parti politike që do të fitonte mandate parlamentare me sistemin SMP. Komunitetet pakicë janë llogaritur si të tilla, me qëllim të agregimit të votave të tyre. Në këtë mënyrë, janë bashkuar votat e të gjitha partive të komunitetit serb, si dhe votat e boshnjakëve dhe goranëve.

Tabela 8: Krahasim i rezultatit të përgjithshëm të simulimit të SMP-së sipas rezultateve të zgjedhjeve të vitit 2010

Partitë	Përqindja e votave totale	Ndarja aktuale e mandateve parlamentare	Skenari i ndarjes proporcionale të mandateve pa mandate të rezervuara me metodën Sainte-Laguë	Skenari i ndarjes së mandateve sipas sistemit SMP	Ndikimi i SMP në proporcionalitet të përfaqësimit	Numri mesatar i votave për kandidat për parti sipas sistemit SMP
PDK	32.11%	34	41	57	+16	3935
LDK	24.69%	27	32	31	-1	5553
VV	12.69%	14	15	2	-13	44326
Serbët	4.35%	13	6	9	+3	3003
KKR	7.29%	8	9	4	-5	12737
AAK	11.04%	12	13	15	+2	5142
Boshnjakët dhe Goranët	1.56%	5	2	2	0	5547
Turqit	1.22%	3	1	1	0	1099
RAE	0.75%	4	1	0	-1	NA
Totali		120	120	120	/	/

Nga simulimi i mësipërm shihet se sistemi mazhoritar krijon përparësi të mëdha për partitë më të mëdha. Kjo përparësi vërehet sidomos tek partia me më së shumti vota. Koncentrimi gjeografik i disa partive në zgjedhjet e vitit 2010 bën që rezultatet e SMP të mos krijojnë efektet e zakonshme të cilat ky sistem i krijon në vendet që e përdorin atë tradicionalisht, e që kanë numër më të vogël të partive politike. Për shembull, shihet se në sistemin mazhoritar, nëse do të garonte vetëm një parti e serbëve të Kosovës, ajo do të kishte më shumë mandate parlamentare sesa me proporcional të pastër, pa mandate të rezervuara. Në anën tjetër, AAK do të kishte më shumë mandate parlamentare sesa VV-ja, edhe pse VV-ja ka numër më të madh të përgjithshëm të votave. Arsyeja për këtë është se VV-ja në vitin 2010 nuk ka pasur bazë regjionale e cila do t'ia mundësonte dominimin në një numër zonash elektorale, por vota e saj është e shpërndarë në mbarë territorin e Kosovës.

Megjithatë, kjo pasqyrë nuk reflekton ndonjë situatë reale për arsye se zgjedhjet në vitin 2010 janë mbajtur sipas sistemit proporcional dhe me vende të rezervuara në parlament, pra me një numër të madh të partive që kanë garuar, e që ka pasur ndikim edhe në mënyrën se si kanë votuar votuesit. Duhet vërejtur se simulimi i shndërrimit të rezultateve të sistemit proporcional në SMP mund të japë treguesit e trendit, por rezultatet mbeten të diskutueshme, për dallim prej simulimit të shndërrimit të rezultateve të SMP-së në proporcional që do të jepte rezultatet më të përafërta. Megjithatë, duhet theksuar se qëllimi i këtij simulimi është që në bazë të rezultateve pak a shumë të përafërta të tregohet se cilat do të ishin efektet eventuale politike të aplikimit të SMP-së në rastin e Kosovës.

Megjithatë, duhet theksuar se sistemi SMP do të kishte pasoja të mëdha për skenën politike të Kosovës. Së pari, një pjesë e minoriteteve, sidomos komuniteti rom, ashkali, egjiptian që janë të shpërndarë si popullatë në vise të ndryshme të Kosovës, do të duhej që të integroheshin brenda partive të shumicës sipas interesit të tyre, ose do të duhej t'u garantohej një përfaqësim sipas

përqindjes së popullsisë. Së dyti, serbët e Kosovës, të koncentruar nëpër komunat me shumicë serbe, do të vazhdonin të kishin një përfaqësim që është pak a shumë i barasvlershëm me vendet e garantuara. Megjithatë, politikëbërja e tyre nuk do të kishte domosdoshmërisht kthesa integruese, sepse gara politike do të kufizohej në komunat me shumicë serbe.

Sa u përket serbëve që jetojnë jashtë komunave me shumicë serbe, si dhe jo-serbëve që jetojnë në komunat me shumicë serbe, por edhe pakicave të tjera nëpër zonat zgjedhore nëpër Kosovë, do të mund të luanin një rol të rëndësishëm në përcaktimin e fituesve në zgjedhje, duke tërhequr kështu një qasje të moderuar nga ana e subjekteve politike për të drejtat e komuniteteve pakicë.

Megjithatë, mbeten këto gjetje kryesore nga aplikimi i SMP-së në Kosovë:

- Në rrethanat aktuale, kalimi në SMP do të gjeneronte një rritje të ndjeshme të vendeve në parlament për partinë me më së shumti vota, por nuk do të kishte efekt ndryshimesh të menjëhershme në skenën politike. Këto efekte mbase do të mund të shiheshin në një afat më të gjatë dhe varësisht edhe nga cilësia e kandidatëve të partive politike. Duke qenë se në sistemin SMP votohet drejtpërdrejtë për kandidatin, partitë politike do të duhej të kujdeseshin që të kandidonin me figura që do të kishin ndikim më të madh në zgjedhjen e votuesve sepse njëra ndër pasojat e SMP-së do të mund të ishte edhe zbehja e lojaliteteve partiake të shprehura në sistemin proporcional;
- Kalimi në SMP nuk do të ishte zgjidhja më e mirë për shkak se Kosova tashmë ka krijuar një traditë të proporcionalitetit dhe një ndërrim aq radikal i sistemit zgjedhor do të mund të shkaktonte trauma politike të paparashikueshme. Kjo do të ndërpritej një evolucion politik i cili është vendosur nga sistemi proporcional;
- Sipas këtij simulimi që ka aplikuar parimin 'Një komunë një zonë zgjedhore', komunitetet pakicë në përgjithësi do të dëmtoheshin, përveç serbëve të cilët do të siguronin kuotën aktuale të mandateve të garantuara. Problemi do të vazhdonte të mbetej se si të sigurohet përfaqësimi i komuniteteve nga pakicat tjera jo serbe.

Vota alternative

Vota alternative është përdorur për herë të parë në Australi në fund të shekullit XIX dhe përdoret në disa vende të Oqeanisë. Është sistem mazhoritar i komplikuar dhe i ngjason deri diku sistemit proporcional VVT për të cilin flitet në seksionin e ardhshëm. Megjithatë, vota alternative është shumë e rekomanduar për vendet shumë-etnike. Sipas Horowitz¹³, vota alternative bën moderimin e liderëve etnikë, për shkak se i shtyn ata që të kërkojnë votat e grupeve të tjera etnike. Ky parim do të ishte vështirë i aplikueshëm në Kosovë, për arsye se pakicat janë në një numër shumë të vogël, por shihet si sistem zgjedhor i përshtatshëm për vendet ku grupet etnike janë përafërsisht të barabarta në pikëpamje demografike. Ky sistem përndryshe quhet sistem i votimit preferencial, sepse këtu votohet për preferencën e parë, të dytën etj. Kjo mund të ketë për pasojë që kandidati, i cili në raundin e parë të numërimit të votave ka më së shumti vota, por i mungon shumica prej 50% + 1

¹³ Donald L. Horowitz: Making Moderation Pay: The Comparative Politics of Ethnic Conflict Management, in: Joseph V. Montville (ed.): Conflict and Peacemaking in Multiethnic Societies, Lexington 1991, f. 451-476.

votë, të mos arrijë të zgjidhet në parlament për shkak se i mungon numri i mjaftueshëm i votave preferenciale, si preferencë e dytë, e tretë etj. Më poshtë po paraqesim disa përparësi dhe mangësi të votës alternative, sipas përvojës së vendeve të tjera.

Tabela 9: Përparësitë dhe mangësitë e Votës alternative (VA)

VOTA ALTERNATIVE	
PËRPARËSITË	MANGËSITË
Mundëson zgjedhjen në mes të shumë kandidatëve dhe lejon preferencat	Mundëson marrëveshjet në mes të partive/kandidatëve dhe votimin taktik që jo gjithmonë mund të jetë i shtyrë nga moderimi
Përfaqësimi i votuesve në mënyrë të drejtpërdrejtë	Një pjesë e konsiderueshme e votave të para humbasin
Ka efekt moderues	Numri i pakicave etnike në Kosovë është i vogël për të aplikuar këtë sistem

Një rast shumë interesant është paraqitur në zgjedhjet për Parlamentin e Australisë, në një zonë zgjedhore me gjashtë kandidatë, në të cilin kandidati me më së shumti vota në raundin e parë të numërimit nuk ka arritur të zgjidhet për shkak se në vota preferenciale ka dominuar kandidati i dytë me radhë, i cili është zgjedhur në parlament.

Tabela 10: Rezultati i zgjedhjeve me votë Alternative (Preferenciale) për Parlamentin e Australisë në Divizionin Hinkler në Queensland në vitin 1998¹⁴

Kandidati	Numërimi 1	Ndarja e preferencave	Numërimi 2	Ndarja e preferencave	Numërimi 3	Ndarja e preferencave	Numërimi 4	Ndarja e preferencave	Numërimi 5	
A	26471	45	26516	223	26739	807	27546	8877	3642 3	Kandidati i zgjedhur
B	29021	39	29060	353	29413	987	30400	5533	3593 3	Kandidati nr. 1 në raundin e parë
C	1139	48	1187	Përjashtuar						
D	13739	61	13800	169	13969	441	14410	Përjashtuar		
E	1677	116	1793	442	2235	Përjashtuar				
F	309	Përjashtuar								

Variacionet e sistemeve proporcionale

Aktualisht Kosova e përdor sistemin proporcional me një zonë të vetme zgjedhore dhe me formulën e përkthimit të votave në mandate parlamentare Sainte-Laguë.¹⁵ Përveç kësaj, partitë që përfaqësojnë pakicat etnike nuk kanë prag zgjedhor, për dallim nga partitë që nuk deklarojnë se përfaqësojnë pakicat, e për të cilat vlen pragu zgjedhor prej 5%. Kjo nuk është diçka e pazakontë dhe aplikohet në shumë vende demokratike. Sistemi proporcional me një zonë zgjedhore dhe me kalkulimin Sainte-Laguë është më i favorshmi për pakicat dhe për partitë e vogla. Ai ka për qëllim të maksimizojë proporcionalitetin dhe me këtë të inkurajojë lindjen e opsioneve të reja politike, si dhe të maksimizojë përfaqësimin e komuniteteve pakicë.

Për çështjen e aplikimit të një apo më shumë zonave zgjedhore dhe ndikimin e tyre në proporcionalitetin (përpjesëtimërinë) e përfaqësimit në Kosovë është folur gjerësisht në punime tjera.¹⁶ Prandaj, ky studim nuk do të merret me sistemin proporcional me më shumë zona zgjedhore, por do të shqyrtojë sistemin proporcional të votës së vetme të transferueshme (VVT) si mundësi për Kosovën.

¹⁴ David M. Farrell: Electoral Systems: A Comparative Introduction, New York 2001, f. 58.

¹⁵ Kosova ka edhe 20 mandate parlamentare të rezervuara për partitë që përfaqësojnë pakicat të cilat ndahen në mes tyre sipas votës proporcionale.

¹⁶ Shih Zonat zgjedhore, Demokraci për Zhvillim D4D, 2011. Qasur më 25 Dhjetor 2013, në: <http://d4d-ks.org/assets/2011-12-13-OrganizimiZonave-zgjedhore.pdf>

Vota e vetme e transferueshme (VVT)

Janë dy lloj sistemesh proporcionale: sistemet e listave dhe ato me garimin e kandidatëve individualë (VVT). Ky lloj i sistemit proporcional është më i rralli që përdoret, edhe pse literatura politologjike e konsideron si njërin prej sistemeve më të mira proporcionale.¹⁷ Në fakt, ky proporcional përdoret vetëm në vendet që kanë qenë të sunduara nga Britania e Madhe dhe që kanë zgjedhur një formë të sistemit proporcional të zgjedhjeve. Karakteristikë themelore që e tregon praktika, është se VVT përdoret në vendet me numër më të vogël të popullsisë. VVT-ja përdoret nga Australia (për Senat), Republika e Irlandës, Malta dhe Irlanda Veriore.

Çfarë dallon VVT nga nënsistemet e tjera proporcionale? Për dallim nga nënsistemet proporcionale me listat e mbyllura, këtu zgjedhësit mund të votojnë për më shumë se një kandidat, madje edhe për kandidatët e partive të ndryshme, duke i renditur sipas preferencës së tyre: preferenca 1, preferenca 2, preferenca 3, e kështu me radhë. Në Republikën e Irlandës, p.sh., aplikohet preferenciali opcional, në të cilin votuesit mund të zgjedhin prej 1 e më shumë preferencave, kurse në Australi, aplikohet preferenciali i obligueshëm, në të cilin votuesit duhet të votojnë për më shumë se një kandidat dhe në disa zona, ata duhet t'i rreshtojnë preferencat e tyre në mesin e të gjithë kandidatëve.

Ndarja e mandateve tek VVT bëhet përmes kuotës Droop, e cila bazohet në numrin e votave dhe numrin e kandidatëve që duhet zgjedhur.¹⁸ Farrell e sqaron kuotën në këtë mënyrë, duke përdorur numrin e votuesve 1000: Kuota Droop = $\{\text{Numri total i votave} / \text{Numri total i mandateve} + 1\} + 1$. Për shembull, nëse do të kishim një zonë zgjedhore prej 1000 votuesish ku do të zgjidheshin 5 kandidatë, atëherë, kuota Droop do të ishte kjo: $1 + (1000/5 + 1) = 167$.

Për të ilustruar se si funksionon VVT, do të mbështetemi tek shembulli i dhënë nga Gallagher dhe Mitchell.¹⁹ Votuesit mund të votojnë për një ose më shumë preferenca në listat e kandidatëve nga parti të ndryshme duke i radhitur preferencat e tyre me numër 1, 2, 3, 4, 5, varësisht prej numrit të preferencave, ose mund të votojnë vetëm preferencën e tyre të parë, varësisht se a do të obligonte ligji zgjedhor votimin e disa preferencave apo jo. Ky parim i votimit preferencial funksionon njëllë sikurse në sistemin e VA, të shpjeguar më lartë.

Kur vie tek numërimi i votave, atëherë përdoret kuota e cila bazohet në formulën e mësipërme. Për shembull, në zgjedhjet e vitit 1987 në Irlandë, në zonën zgjedhore të Korkut, kanë qenë 33404 vota të vlefshme në të cilat votuesit kanë zgjedhur 3 prej 5 kandidatëve që kanë garuar në zgjedhje. Kuota Droop është kalkuluar duke pjesëtuar numrin e votave të vlefshme me numrin e mandateve plus 1. Duke qenë se gara bëhet për 3 mandate, numri total i votave të vlefshme pjesëtohet me numrin 4 dhe i shtohet numri 1: $33404 / 4 = 8351 + 1 = 8352$. Sipas këtij pjesëtimi, del se kuota Droop ka qenë 8352 vota, që është edhe pragu i votave të cilin duhet ta arrijnë kandidatët e zgjedhur.

Në rrethin e parë të numërimit, llogariten vetëm preferencat e para. Nëse ndonjëri prej kandidatëve arrin kuotën e përcaktuar, ai zgjidhet. Nëse jo, atëherë në rrethin e dytë të numërimit llogariten

¹⁷ John McGarry, Brendan O'Leary: Consociational Theory, Northern Ireland's Conflict, and its Agreement 2. What Critics of Consociation Can Learn from Northern Ireland, in: *Government & Opposition*, 41(2), 2006, f. 249-277.

¹⁸ David M. Farrell: *Electoral Systems: A Comparative Introduction*, New York 2001.

¹⁹ Michael Gallagher, Paul Mitchell: Introduction to Electoral Systems, in: Michael Gallagher and Paul Mitchell (eds.): *The Politics of Electoral Systems*, New York 2008, f. 594-595.

preferencat e dyta. Në rast se ndonjëri prej kandidatëve ka numrin e votave shumë të vogël për të vazhduar garën, ai eliminohet dhe numërohen preferencat e tij të dyta. Nëse nga këto preferenca, ndonjëri nga kandidatët arrin ose tejkalon kuotën prej 8352 votash, atëherë ky kandidat zgjidhet, kurse teprica e tij e votave kalon tek kandidatët e tjerë sipas preferencave të shprehura nga votuesit derisa edhe kandidati tjetër të arrijë kuotën e kështu me radhë derisa të gjithë kandidatët e arrijnë kuotën e përcaktuar. Pra, në VVT, numërohen edhe teprica e votave të kandidatëve të zgjedhur, edhe mbetja e votave të kandidatëve të eliminuar. Ilustrimi i rastit mund të shihet në tabelën 11.

Tabela 11: Paraqitja e llogaritjes së votave nga modifikimi i tabelës nga zgjedhjet e vitit 1987 në zonën zgjedhore të Korkut në Irlandë²⁰

Votat e vlefshme: 33404

Kuota Droop: 8352 [sepse $33404/3:1 = 8351$, dhe shtohet 1]

	Preferencat e para	Eliminimi i kandidatit të pavarur (pa gjasa)	Kalkulimi i preferencave të dyta të kandidatit të pavarur të eliminuar	Rrethi i dytë: rezultati i transferit të votave sipas preferencës së dytë të kandidatit të pavarur	Teprica e votave të kandidatit popullor dhe preferencat e ardhshme të transferuara	Rrethi i tretë: transferi i votave tepricë të kandidatit popullor
Socialist	7057	–	1292	8349	130	8479 zgjedhur
Popullor	7431	–	1087	8518 zgjedhur	- 166	8352
Liberal	7777	–	566	8343	12	8355 zgjedhur
Pavarur	3796	-3796	eliminuar	–	–	–
Ambientalist	7343	–	564	7907	24	7931
Votat jo të transferueshme të kandidatit të pavarur	–	–	287	287	–	287
Total	33404	–	–	33404	–	33404

Në tabelën 11 është paraqitur njëra prej mënyrave se si llogariten votat e bartura nga preferencat e dyta, sepse mënyra e llogaritjes së këtyre preferencave „ndryshon nga vendi në vend”.²¹

²⁰ Adaptuar nga: Michael Gallagher, Paul Mitchell: Introduction to Electoral Systems, in: Michael Galagher, Paul Mitchel (ed.): The Politics of Electoral Systems, New York 2008, f. 595.

²¹ Po aty.

Më poshtë po paraqesim disa nga përparësitë dhe mangësitë e VVT. Mangësia kryesore e VVT për Kosovën është mungesa e kapaciteteve dhe kulturës demokratike, sidomos kur bëhet fjalë për numërimin e votave në mënyrë të ndershme. Në anën tjetër, përparësitë për sa i takon efekteve politike do të ishin të mëdha për shkak të disagregimit të preferencave të votuesve ndërmjet partive të ndryshme politike, që do të ndikonte ndjeshëm në uljen e tensioneve politike në Kosovë.

Tabela 12: Përparësitë dhe mangësitë e sistemit proporcional VVT

SISTEMI VVT	
PËRPARËSITË	MANGËSITË
Votohet drejtpërdrejt për kandidatin	Votimi mund të jetë i komplikuar dhe mund të shkaktojë huti tek votuesit
Përfaqësimi i votuesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe u jep shanse të gjitha partive	Numërimi është i komplikuar
Ka efekte moderuese në vendet me diversitet etnik	Mund të ketë marrëveshje në mes të partive për ndarje të preferencave – Votimi taktik
Si pasojë e votimit taktik, mund të lehtësojë krijimin e koalicioneve	VVT arrin të gjenerojë përfaqësim proporcional në parlament, por mund të krijojë konfuzion të politikave.

Konkluzion

Meqenëse Kosova gjendet në udhëkryq për sa i takon vendimit për të pasur një sistem zgjedhor, me pak mundësi për zgjedhje në mesin e një numri më të madh të sistemeve zgjedhore, ky studim nuk ka për qëllim që të rekomandojë një sistem të veçantë zgjedhor. Në fakt, qëllimi i këtij studimi është të informojë palët e interesit dhe publikun e interesuar me gamën e mundësive të cilat mund të diskutohen më tej, duke mos paragjykuar përparësitë apo mangësitë të cilitdo sistem zgjedhor. Në vijim paraqiten konkluzionet e përmbledhura për secilin sistem zgjedhor të paraqitur në këtë studim.

SMP: Në parim, ky sistem do të ishte i përshtatshëm për Kosovën, por në praktikë do të mund të nxirrte probleme rreth akomodimit të skenës politike. Sistemi SMP ka qenë kërkesa kryesore e partive politike kosovare në vitin 2001 gjatë diskutimeve për Kornizën Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë dhe ka ekzistuar një dozë e mbështetjes ndërkombëtare për këtë sistem.²² Përse do të ishte SMP i përshtatshëm në parim dhe më pak i përshtatshëm në praktikë? Në parim, Kosova ka një strukturë demografike të përshtatshme për sistemin SMP. Megjithatë, ky sistem do të mund të aplikohet duke i kushtuar kujdes përfaqësimit të grupeve etnike, qoftë përmes garantimit të mandateve parlamentare, ose përmes aplikimit të rregullimit territorial të një numri të caktuar të distrikteve zgjedhore që do të mundësonin përfaqësimin edhe të grupeve etnike, edhe të komunave të vogla. Në njërin anë, të drejtat e pakicave nuk varen domosdoshmërisht nga mbipërfaqësimi nëse Kushtetuta dhe legjislacioni, si dhe funksionimi i mekanizmave balancues, garantojnë të drejtat e pakicave sipas marrëveshjeve ekzistuese ndërkombëtare dhe një përfaqësim proporcional. Në anën tjetër, në praktikë kjo duket më e vështirë. Skena politike kosovare ka evoluar në një sistem krejtësisht tjetër zgjedhor. Një ndryshim kaq i madh i sistemit zgjedhor do të mund të shkaktonte çarje të mëdha politike dhe sociale në Kosovë. E vetmja mundësi me të cilën do të mund të aplikohet ky sistem zgjedhor do të ishte një konsensus për një kornizë të re politike e juridike.

Sistemi mazhoritar me balotazh (dy raunde): Ky sistem është aplikuar me sukses në zgjedhjet për kryetarë komunash. Nuk është praktik për aplikim në zgjedhjet parlamentare, por mund të aplikohet në zgjedhjet presidenciale. Arsyeja për këtë është se sistemi mazhoritar me dy raunde ka kosto shumë të lartë financiare, merr shumë kohë dhe kjo do të mund të ndikonte që një pjesë e mirë e kohës së partive politike dhe të qeverisë të përqendroheshin në zgjedhje e jo në çështjet praktike të qeverisjes.

Vota alternative: Ky sistem zgjedhor është atraktiv në pikëpamje të zgjerimit të opsioneve politike për votuesit në bazë të preferencave të tyre. Për dallim prej SMP, në të cilin zgjidhet kandidati me më së shumti vota, Vota alternative u jepë gjasa të mëdha preferencave të dyta të votuesve, sepse kërkon medoemos 50%+1 votë për t'u zgjedhur, gjë që është vështirë e arritshme në SMP. Në pikëpamje të marrëdhënieve ndëretnike, ky sistem nuk do të ishte praktik për Kosovën për shkak të numrit të vogël të pakicave në Kosovë dhe për këtë shkak, mungesës së nxitjes për partitë e shumicës që t'u drejtohen pakicave më ofertat e tyre politike. Në këtë kontekst, sistemi mazhoritar-

²² Intervista me dy përfaqësues ndërkombëtarë dhe vendorë në bisedimet për Kornizën Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse në 2001, në: Arben Qirezi: Intervention and Consociationalism: The Role of External Dimension in Shaping Post-war Kosovo 1999-2012, unpublished Ph.D. Thesis, National University of Ireland Galway, Galway 2014.

preferencial do të mund të gjeneronte ndryshime në bazë të preferencave të dyta, por edhe votim taktik nga ana e votuesve besnikë të partive politike në votën e tyre preferenciale.

Sistemi proporcional me votë të vetme të transferueshme (VVT): Sikur edhe vota mazhoritare-preferenciale, edhe VVT bazohet në preferencat e votuese, me dallimin që këtu ndarja e mandateve, për shkak se është fjala për zonat shumëmandatëshe, bëhet proporcionalisht sipas kuotës së kërkuar dhe nuk nevojiten 50%+1 votë për t'u zgjedhur. Si e tillë, VVT është atraktive në kuptimin e lëvizjes së preferencave nga partia në parti gjë që paraqet nxitje për moderim. Megjithatë, problem kryesor për aplikimin e tij në Kosovë është procesi shumë i komplikuar i numërimit të votave, për të cilën Kosova nuk është krejtësisht e gatshme në këtë periudhë.

Shtojcë

Figura 1: Vota proporcionale sipas rezultateve zgjedhore të vitit 2010 pa mandate të rezervuara




Figura 2: Mandatet parlamentare aktuale me mandate të rezervuara




Figura 3: Ndarja e mandateve parlamentare në mënyrë proporcionale pa vende të rezervuara




Figura 4: Simulimi i ndarjes së mandateve parlamentare sipas sistemit SMP në bazë të votave për parti (jo për kandidatë) në vitin 2010

